

VENDIM
Nr. 831, datë 19.12.2022

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 43/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kapitullin V, pika 2, “Përdorimi i sallës VIP të aeroportit”, në fund të nënpikës 3 shtohen këto autoritete:

- “... - Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit;
 - Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
 - Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
 - Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
 - Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
 - Kryetari i Gjykatës së Posaçme;
 - Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
 - Komisionerët publikë;
 - Drejtori i Shkollës së Magjistraturës;
 - Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit...;”.

2. Në kapitullin VI, pika 1, “Përparësia në Republikën e Shqipërisë”, në rangun II të përparësive bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit “... kryetari i Gjykatës së Lartë...” shtohen:

- “... - Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
 - Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
 - Kryetari i Gjykatës së Posaçme...;”.

b) Pas fjalëve “... anëtarët e Gjykatës Kushtetuese...” shtohen “... Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit...”.

c) Pas fjalëve “... anëtarët e Gjykatës së Lartë...” shtohen:

- “... - Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
 - Anëtarët e Prokurorisë së Posaçme;
 - Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
 - Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
 - Anëtarët e Gjykatës së Posaçme;
 - Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
 - Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
 - Komisionerët publikë;
 - Drejtori i Shkollës së Magjistraturës...;”.

ç) Pas emërimit “Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit” shtohet “Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

II. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku